



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E  
POLICISË SË SHTETIT**

Nr. 2729 Prot. Datë 28.08.2015

Nr. 5346 Prot. Datë 31.08.2015

**AGJENCIA E KTHIMIT  
DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE**

**AVOKATURA E  
PËRGJITHSHME E SHTETIT**

Nr. 2981 Prot. Datë 31.08.2015

Nr. 1733 Prot. Datë 31.08.2015

## **MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

Të vetëdijshëm për nevojën dhe rëndësinë e bashkëpunimit të gjerë në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave pasurore të shtetit dhe të shtetasve;

Me qëllim rritjen e shkallës së ndërveprimit për një funksionim efektiv të bashkëpunimit dhe përmirësimin e veprimtarisë së institucioneve;

Mbështetur në Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr.9737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.108/2014 “Për policinë e shtetit”, ligjin nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar, ligjin nr.10018 datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi;

Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, që këtej e tutje referuar si “Palë”, nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi:

### **Neni 1**

#### **Objekti**

1. Objekti i kësaj Marrëveshjeje është forcimi i bashkëpunimit për të garantuar mbrojtjen e të drejtës së pronës nga veprimtaria kriminale e kryer nëpërmjet falsifikimit ose përdorimit të dokumenteve të falsifikuara.

## **Neni 2**

### **Detyrime të Prokurorisë së Përgjithshme**

#### **1. Prokuroria angazhohet:**

- a) Të iniciojë procedimin penal për çdo njoftim për vepra penale që lidhen me falsifikimin e dokumentave të cilat prekin të drejtën e pronës ose nga të cilat lindin të drejta pronësie, duke drejtuar dhe kryer hetimet e nevojshme për mbledhjen e provave, ku përfshihen domosdoshmërisht kryerja e ekspertimeve, marrja e dokumenteve, dhe çdo gjë tjetër që i shërben procesit penal;
- b) Të njoftojë Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit, për regjistrimin e procedimit penal kur preken interesat shtetërore sipas objektit të kësaj Marrëveshjeje dhe vendimmarrjen në përfundim të hetimeve paraprake;
- c) Të njoftojë Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për fillimin e procedimit penal të kallëzuar prej saj dhe vendimmarrjen në përfundim të hetimeve paraprake;
- ç) Në rastin e pushimit të çështjes, të disponojë mbi provat materiale sipas ligjit, si dhe të njoftojë Palët dhe shtetasit e interesuar jo vetëm për të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në gjykatë, por edhe për të drejtat civile që lindin nga kjo vendimmarrje;
- d) Në rastin e gjykimit të çështjes, të ndjekë me përparësi ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë, për detyrimet që lindin në lidhje me pasojat e deklarimit të falsitetit të dokumentit.

## **Neni 3**

### **Detyrime të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit**

#### **1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit angazhohet:**

- a) Të bashkëpunojë me institucionet e tjera shtetërore dhe shtetasit për të marrë dijeni për veprimtarinë kriminale objekt i kësaj Marrëveshjeje;
- b) Të kryejë me përgjegjësi veprimet hetimore të urdhëruara ose deleguara nga prokurori dhe në mënyrë të veçantë të kryejë me profesionalizëm ekspertimet nga policia shkencore, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale;
- c) Të shfrytëzojë maksimalisht burimet njerëzore dhe materiale në interes të parandalimit, zbulimit dhe hetimit të veprimtarisë penale objekt i kësaj Marrëveshjeje;

## **Neni 4**

### **Detyrime të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**

1. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave angazhohet:
  - a) Të bëjë kallëzim penal në prokurori kur merr dijeni për kryerjen e veprave penale objekt i kësaj Marrëveshjeje, duke vënë në dispozicion të prokurorit elementet thelbësore të faktit, burimet e proves dhe çdo gjë tjetër që vlen për hetimin e plotë të çështjes e për identifikimin e autorit;
  - b) Të sigurojë mbrojtjen dhe fshehtësinë e informacionit, provave, akteve dhe/ose të dhënave të tjera, deri në përfundim të hetimeve paraprake.

## **Neni 5**

### **Detyrime të Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit**

1. Avokatura e Përgjithshme e Shtetit angazhohet:
  - a) Të bëjë kallëzim penal në prokurori kur merr dijeni për kryerjen e veprave penale objekt i kësaj Marrëveshjeje, duke vënë në dispozicion të prokurorit elementet thelbësore të faktit, burimet e proves dhe çdo gjë tjetër që vlen për hetimin e plotë të çështjes e për identifikimin e autorit;
  - b) Të ngrejë padi civile në procesin penal kur konstatohet se preken interesat pasurore të shtetit nga veprimtaria objekt i kësaj Marrëveshjeje;
  - c) Me njoftimin e vendimit përfundimtar të prokurorit, të ushtrojë të drejtën e padisë në gjykatë, për mbrojtjen e interesave shtetërore;
  - ç) Të sigurojë mbrojtjen dhe fshehtësinë e informacionit, provave, akteve dhe/ose të dhënave të tjera, deri në përfundim të hetimeve paraprake.

## **Neni 6**

### **Administrimi i informacionit dhe i dokumentacionit**

1. Palët do ta trajtojnë informacionin e marrë në zbatim të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

## Neni 7

### Dispozita të fundit

1. Secila palë merr përsipër njohjen e strukturave të varësisë me detyrimet e kësaj Marrëveshjeje, si dhe respektimin e zbatimin e detyrimeve që rrjedhin prej saj.
2. Për çdo rast të mosplotësimit të detyrimeve të mësipërme secila palë të informojë titullarin e institucionit.
3. Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe do të zbatohet me afat të pacaktuar.
4. Marrëveshja përpilohet në 4 (katër) kopje dhe secila palë mban nga një kopje të njëjtë.

**PROKURORIT PËRGJITHSHËM**

**ADRIATIK LLALLA**



**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I  
POLICISË SË SHTETIT**

**HAKI ÇAKO**



**DREJTORE E PËRGJITHSHME E  
AGJENCISË SË KTHIMIT DHE  
KOMPENSIMIT TË PRONAVE**

**SONILA QATO**



**AVOKATE E PËRGJITHSHME E  
SHTETIT**

**ALMA HICKA**

